V E N D I M
Nr. 83, datë 4.2.1998

PËR CAKTIMIN E EKSPERTËVE KONTABËL TË PAVARUR DHE TË ADMINISTRATORËVE NË SHOQËRINË "GJALLICA SH.P.K.

Me propozimin e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në shoqërinë "Gjallica" sh.p.k. ndaj së cilës organi i prokurorisë ka filluar çështjen penale, caktohen ekspertë kontabël të pavarur për një kohë prej 6 muajsh, deri në mbyllje të procesit të gjykimit.

2. Për objektet në veprimtari prodhimi dhe për ato që mund të riaktivizohen, vendosen administratorë lokalë si në:

-klinikën stomatologjike "Dentalba" në Tiranë;
-fabrikën e qumështit në Libohovë;
-fabrikën e kripës në Vlorë;
-fabrikën e tullave në Vlorë.

3. Numri i ekspertëve kontabël të pavarur për këtë shoqëri të jetë 6 veta dhe i administratorëve lokalë 4 veta, sipas listës që i bashkëngjitet këtij vendimi.

4. I rekomandohet prokurorisë, që për sa kohë vazhdon procesi i hetimit dhe i gjykimit, mund të thërresë për zbërthimin e materialit të ekspertizës, specialistë të Kontrollit të Lartë të Shtetit që kanë punuar për përgatitjen e tij.

5. Paga bazë mujore e ekspertëve kontabël të pavarur dhe e administratorëve që do të vendosen në objektet e shoqërisë "Gjallica", sh.p.k. të jetë 30-35 mijë lekë në muaj dhe caktohet nga vetë organi i prokurorisë.

6. Prokurorisë së Përgjithshme, për të përballuar pagat e ekspertëve kontabël të pavarur dhe të administratorëve, në planin e vitit 1998 i shtohen 2.5 milionë lekë nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LISTA EMËRORE E PERSONAVE QË DO TË CAKTOHEN SI EKSPERTË KONTABËL TË PAVARUR DHE ADMINISTRATORË NË SHOQËRINË "GJALLICA" SH.P.K.

Personat që mund të vendosen si ekspertë kontabël:

1. Arben Abazi
2. Liliana Enesi
3. Astrit Qerimi
4. Sadedin Zeqo
5. Astrit Balla
6. Shkëlqim Balla
7.
8.
9.

Personat që mund të vendosen si administratorë:

1. Burbuqe YmeriKlinika "Dentalba", Tiranë
2. Luiza Bejtja (Dinaj)Fabrika e Tullave, Tiranë

Fabrika e Qumështit, Libohovë

Fabrika e Kripës, Vlorë
4.